



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	08.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-09/14
PËR/ZA/TO:	z. Avni Sahiti, Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Sahiti,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, Neni 19 (paragrafi 1.5) dhe Neni 19 (paragrafi 1.6) i Ligjit Nr.04/L-051), lidhur me kërkesën tuaj, Agjencia Kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Nuk ekziston Konflikt Interesi në rastin kur shërbyesi civil i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka fituar tender nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për ndërtim të shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë të Komunës së Rahovecit.

ARSYETIM

Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar kërkesë nga z. Avni Sahiti – Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, me numër të protokollit 03-3095/14, me të cilën është kërkuar nga ne si autoritet kompetent për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, të shqyrtohet situata e mundshme e konfliktit të interesit kur z. Florim Kryeziu, inxhinier i punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe të Sportit (Shërbyes civil), ka fituar tender në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës në fshatin Xërxë të Komunës së Rahovecit

Në këtë situatë, z. Florim Kryeziu, Inxhinier i punësuar (shërbyes civilë) në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe të Sportit, ka fituar tender në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për ndërtimin e shtëpisë së Kulturës në fshatin Xërxë të Komunës së Rahovecit, si fitues i kësaj kontrate nuk kemi situatë me Konflikt Interesi.

Ndërsa zyra e prokurimit në konsultim me zyrën ligjore mund të bëjnë kufizime sa i përket kontratës për autoritetin kontraktues dhe menaxherin e projektit.

Në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, sipas nenit 5 të këtij Ligji, pozita e inxhinierit nuk hynë në kategorinë e zyrtarëve të lartë, dispozitat e këtij Ligji i obligojnë vetëm zyrtarët e lartë publik.

Rjedhmisht Kodi i mirësjelljes për nëpunësit civil 01/2006, në nenin 15 i obligon shërbyesin civil të shmangin konfliktin e interesit, ndërsa neni 18 i këtij kodi shprehimisht thotë:

Nëpunësi duhet ta shfrytëzojë kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk shfrytëzohet për asnjë qëllim tjetër, përveç se në rastet kur shfrytëzimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Agjencia Kundër Korrupsionit është autoriteti qendror në zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, te zyrtarët e lartë publik, dhe nuk mund të bëjë kufizime për shërbyesit civil.

Sipas, neni 8 (paragrafi 1,2,3,4,5,6) përcakton detyrimet e zyrtarit të lartë për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Bazuar në nenin 8 (paragrafi 5) të Ligjit Nr. 04/L-051, përcakton mos pajtueshmërin me ushtrimin e funksionit publik të zyrtarit të lartë, në të cilin shprehimisht thuhet:

Ndërmarrja në të cilën zyrtari i lartë ka pronësi apo pjesë të pronësisë, e drejtuar nga personi i besuar, nuk ka të drejtë të lidhi kontrate ose të përfitoj ndihme nga institucionet qendrore ose lokale, në të cilat zyrtari i lartë është në pozite vendimmarrëse.

Ndërsa në nenin 13 paragrafi(1,2,3), të këtij Ligji është i përcaktuar Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit të lartë në të cilin shprehimisht thuhet:

Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.

Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.

Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për një çështje të caktuar.

Çdo udhëheqës dhe institucion udhëheqës duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interes, neni 8 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-051.

Me respekt!

